

PROGRAM PUNE PËR REALIZIMIN E CENSUSIT NDËRKOMBËTAR TË SHPENDËVE UJOR DIMËRUES 2020

Hyrje

Mbështetur në Konventat Ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e faunës së Egër, AKZM prej vitesh është përfshirë në realizimin e Censurit Ndërkombëtar të Shpendëve Ujorë Dimërues (CNSHUD). Në këtë proces punonjësit e AdZM-ve, janë përfshirë si vëzhgues dhe numërues gjithashtu.

Ky Census, është vlerësuar me përparësi dhe është ndjekur i veçuar nga vëzhgimi dhe monitorimi i Faunës së Egër në përgjithësi. Censuri Ndërkombëtar i Shpendëve Ujorë Dimërues, nuk është përfshirë në sistemin AKZM - SiMF.

Censuri do të realizohet edhe në zona që nuk përfshihen në sistemin e Zonave të Mbrojtura Mjedisore në vend. Megjithatë teritorët më kryesorë do të jenë ligatinat e vendit. Kështu dëshmohet rëndësia e ligatinave shqiptare, në mbrojtje të biodiversitetit botëror, duke shërbyer ato si mjedise dimëruese për llojet shtegëtare.

Për zogjt shtegtarë, habitatet më të rëndësishme janë ligatinat. Këto zogj pasi kalojnë verën në Europë, lëvizin drejt zonave më të ngrohta gjatë dimrit, duke u bërë kështu banorë të ligatinave të vendit tonë.

Vendet e numërimit dhe metodologjia

Këtë vit, për periudhën 10, 11 dhe 12 Janar 2020, 100 punonjësit e AdZM-ve, përcaktuar për këtë qëllim, ndarë në grupe sipas zonave e vendnumërimeve, ku do të realizohet Censuri, do të përfshihen në proces drejtpërdrejt si numërues, duke u asistuar nga Ekspertët Ornitologë përkatës. Personat që janë aktivizuar edhe në Censurin e viteve të tjera domosdoshmërisht do të caktohen në po të njëjtat vendnumërime. Të gjithë punonjësit e tjerë që përfshihen për herë të parë në këtë Census, para fillimit të punës do të marrin disa njohuri bazë, nëpërmjet shpjegimeve dhe mbikqyerjeve, që do të shërbejnë mbarëvajtjes së procesit.

Mbulimi gjeografik me punonjës dhe ekspertëve është përcaktuar dhe disponohet prej tyre. Në përgjithësi nuk paraqiten probleme për kryerjen e censusit. Kjo bazuar në përvojën e viteve të kaluara, për zonat e përcaktuara prej vitesh. Për secilën zonë të re, (rezervuari Tapizez) vendnumërimet do të përcaktohen nga ekspertët dhe në komunikim e koordinim me ta do të nisë numërimi i shpendëve për realizimin e Censurit.

Metodologjia që do të aplikohet për realizimin e Censurit, do të jetë në dispozicion para fillimit të procesit. Metodologjia do të përfshijë informacion për zonat, mbulimin gjeografik të secilës zonë, vendnumërimet dhe poligonet e sipërfaqes ku do të realizohet numërimi për Censurin. Identifikimi dhe teknikat e monitorimit të shpendëve, organizimi për ndjekjen e procedurave janë hallkat kryesore që çojnë në validimin shkencor të të dhënave për shpendët e ujit, mbi bazën e të cilave do të vlerësohen popullatat e tyre.

Gjithashtu kapacitetet njerëzore që do të merren me realizimin e censusit do të paisen me listën e specieve, me emërtimin e tyre jo vetëm shkencorë por edhe në shqip, si dhe me formularët për shënimin e specieve dhe shifrave përkatëse.

Organizimi

Para fillimit të procesit secila AdZM do të përcaktojë dhe ofrojë një pikë kontakti për secilën zonë, që do të shërbejë mirkoordinimit të punëve midis pjesëmarrësve në proces. Përsa i përket lëvizjeve nëpër zonat ku do të realizohet procesi, vendnumërimet e përcaktuara dhe oraret e vëzhgimit dhe numërimit që do të aplikohen nga secila AdZM, do të jetë me synim për të ndërmarrë numrim të njëkohshëm dhe të

përbashkët, do të ketë detajim konkret përfaqësues të Ekspertëve Ornitologë. Komunikimi me anëtarët e ekipeve të AdZM-ve, detajuar për secilën zonë, midis gjithë të tjerëve përfshirë në process, do të bëjë të mundur shmangien e çdo vështirësie eventuale.

Secili Ekspert Ornitolog, duhet të dërgojë pranë AKZM, listën e mbështetësve të tij në këtë process, duke specifikuar ardhjen e tyre nga/prej të studentëve, Junior Rangers, vullnetarëve, etj.

Pas mbylljes së këtij eventi, nga grupet e punës për çdo zonë realizohet mbledhja e të dhënave të Censurit dhe secili nga ekspertët e angazhuar në bashkëpunim me AdZM-të përkatëse, dërgon tabelën e numurimit pranë AKZM-së brenda muajit Janar 2020. Më pas ekspertët përgatisin analizën e detajuar në bashkëpunim me punonjësit e angazhuar nga çdo AdZM, dhe përgatitet raporti final brenda muajit Shkurt 2020 që paraqitet pranë AKZM-së dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM).

Zonat dhe datat ku e kur do të realizohet Censuri, Përgjegjësat e grupeve me kontaktet përkatëse si edhe ekspertët që do të mbulojnë secilën zonë jepen më poshtë:

Nr	Emërtimi i Zonës	Data e Censurit	Prgjegjësi i grupit	Nr. Kontaktit	Eksperti i angazhuar
1	Liqeni i Shkodrës	10 Janar 2020	Tonin Macaj	0684315219	Erald Xeka
2	Liqeni i Fierzës	11Janar 2020	Besnik Hallaçi	0693011533	Besnik Hallaçi
3	Liqeni i Ulzës	12 Janar 2020	Bekim Qose	0682307406	Besnik Hallaçi
4	Liqeni i Tiranës	11 Janar 2020	Kastriot Skopeci	0684310853	Taulant Bino
5	Liqeni i Farkës	11 Janar 2020	Kastriot Skopeci		
6	Liqeni i Tapizëz	11 Janar 2020	Kastriot Skopeci		
7	Liqeni i Kasharit	11 Janar 2020	Kastriot Skopeci		
8	Liqeni i Paskuqanit	11 Janar 2020	Kastriot Skopeci		
9	Liqeni i Bovillws	11 Janar 2020	Kastriot Skopeci		
10	Liqeni i Banjës	11 Janar 2020	Xhek Nezha	0696666254	Ferdinand Bego
11	Liqeni i Belshit	11 Janar 2020	Xhek Nezha		
12	Liqeni i Thanës	11 Janar 2020	Fatos Nako	0682395162	Ferdinand Bego
13	Liqeni i Prespës së Madhe	11 Janar 2020	Olsi Duma	0683443879	Spase Shumka
14	Liqeni i Prespës së Vogël	11 Janar 2020	Olsi Duma		Spase Shumka
15	Liqeni I Pogradecit	12 Janar 2020	Olsi Buma		Spase Shumka
16	Rezervuari i Bulos	12 Janar 2020	Gligor Dushi	0696621191	Mirian Topi
17	Bunë - Velipojë	11 Janar 2020	Tonin Macaj	0684315219	Denik Ulqini
18	Vau i Dejës	12 Janar 2020	Tonin Macaj		
19	Kune - Vain	12 Janar 2020	Kreshnik Toni	0683375976	Erald Xeka
20	Patok	11 Janar 2020	Kreshnik Toni		Taulant Bino
21	Lalëz – Bisht Pallë	12 Janar 2020	Naim Herri	0692210037	Taulant Bino
22	Shëna - Vlash	12 Janar 2020	Naim Herri		Taulant Bino
23	Karpen	12 Janar 2020	Shpëtim Iseberi	0682148071	Ferdinand Bego
24	Këneta e Osmanit	12 Janar 2020	Shpëtim Iseberi		Ferdinand Bego
25	Divjakë - Karavasta	10 Janar 2020	Ardian Koçi	0698900540	Taulant Bino
26	Gryka e Semanit	12 Janar 2020	Ardian Koçi		Ferdinand Bego
27	Nartë	10 Janar 2020	Nexhip Hysolakaj	0673847379	Mirjan Topi
28	Orikum	11 Janar 2020	Nexhip Hysolakaj		Mirjan Topi
29	Butrint	12 Janar 2019	Nexhip Hysolakaj		

30	Syri i Kaltër	11 Janar 2020	Nexhip Hysolako		
----	---------------	---------------	-----------------	--	--

Numërat e kontaktit me Ekspertët Ornitologë:

Nr	Emer	Mbiemer	Organizata	Kontakti	Akomodimi	Datat
1	Erald	Xeka	AOS	0692445037	Shkodër	10 janar
3	Denik	Ulqini	APAWA	0682182297	Shkodër	11 janar
4	Taulant	Bino	AOS	0692060817	Lalëz	12 janar
5	Ferdinand	Bego	UT	0694070870	Belsh	11 janar
7	Mirjan	Topi	PPNEA	0698694905	Gjirokastër	12 janar
9	Spase	Shumka	UBT	0682351130	Korçë	11 janar

Ditën e Mërkurë, datë 08.01.2020, ora 10, në ambientet e MTM do të organizohet një takim koordinativ me përfaqësues të AdZM-ve dhe Ekspertëve Ornitologë.

Përmbajtja e Axhendës së këtij takimi:

1. Hapja e takimit; Drejtori i Përgjithshëm i AKZM, Z. Zamir Dedej.
2. Prezantimi i kalendarit të punës dhe i shpërndarjes së grupeve të specialistëve /ekspertëve në terren; Z. Fatmir Kryeziu, specialist Menaxhimi AKZM
3. Diskutim për organizimin e punës për datat 10, 11 e 12 Janar 2020
4. Pyetje nga pjesëmarrësit.
5. Mbyllja e takimit